



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2801/3 prot.

Elbasan, me 04.11.2022

VENDIM

Nr 33 datë 04.11.2022


**"Për**

**ngritjen e Komisionit "Ad Hoc", për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave: për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2022-2023, të studentëve të Ciklit të parë të studimeve, për program të parë studimi**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," i ndryshuar, lidhur me procesin e shqyrtimit e miratimit të rasteve për studentët e shkëlqyer, studentët me rezultate dhe studentët që plotësojnë kritere të tjera për: përfitim burse, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2022-2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 04.11.2022

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e Komisionit "Ad Hoc" për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve të shkëlqyer, studentët me rezultate ( me notë mesatare të ponderuar 9.00-10.00) dhe kërkesave të studentëve me kritere të tjera, për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2022-2023, të studentëve të Ciklit të parë të studimeve, për program të parë studimi me përbërje si më poshtë:
  - a) Për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve të shkëlqyer, studentët me rezultate dhe kërkesave të studentëve me kritere të tjera,
    1. Filip Qosja – kryetar
    2. Fatma Spahiu – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
    3. Eda Çela – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
    4. Romina Pitja – anëtare (Përgatitja e kërkesës për përpunim, nxjerrja e certifikatave familjare e-Albania, hartimi i inventarit të dosjes së studentit)
    5. Daniela Gërdani – anëtare (Përgatitja e kërkesës për përpunim, nxjerrja e certifikatave familjare e-Albania, hartimi i inventarit të dosjes së studentit)



6. Fejzie Musta – anëtare (Procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistemin e pagesave)
  7. Arta Skënderi – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistemin e pagesave)
  8. Rovena Zane – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
  9. Armida Gjata – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
  10. Marsela Balla – anëtare (procedura e pritjes së kërkesave të studentëve dhe porokollimi i tyre)
- b) Për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve të shkëlqyer, studentët me rezultate (llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi). Për procedurën e nxjerrjes së rezultateve në FSHMT numri i studentëve në kohën normale është parashikuar mbi 1900 studentë, kështuqë janë propozuar k/sekretarja dhe sekretaret mësimore, ndërsa në fakultetet e tjera vetëm k/sekretarja, pasi ka numër më të ulët studentësh, janë parashikuar nga 390 deri në 780 studentë të ciklit të parë të studimeve.
1. Etleva Sejdini – K/sekretare FSHMT
  2. Blerina Hyra – Sekretare mësimore FSHMT
  3. Aida Mihali – Sekretare mësimore FSHMT
  4. Majlinda Daiu – K/sekretare FSHE
  5. Erjola Piligriu – K/sekretare FE
  6. Blegina Muça – K/sekretare FSHH
  7. Elsona Shevroja – K/sekretare FSHN
2. Komisioni të realizojë pranimin e kërkesës së studentit, të kryejë verifikimin e nevojshëm në zbatim të akteve të mësipërme për këto procedura.
  3. Për studentët e shkëlqyer dhe studentët me rezultate, të merren të dhënat nga Fakultetet e UE-së dhe të bëhet përpunimi i tyre.
  4. Materiali i përgatitur nga komisioni të paraqitet nga Administratori i UE-së në Bordin e Administrimit për shqyrtim e miratim rast pas rasti në zbatim të afateve të përcaktuara në VKM-t përkatëse.
  5. Ngarkohet Administratori dhe Komisioni i mësipërm me zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**  
**ARDIAN DURMISHI**

